



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 61, Datë 21.06.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	DREJTORIA RAJONALE TIRANË / OSHEE SH.A
Hetim administrativ, iniciuar nga	- Agjencia e Prokurimit Publik X - Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
Konstatimet kryesore	Nga shqyrtimi i gjithë informacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ dhe kundërshtimeve të dërguara nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Prokurimit Publik arrin në përfundimin se, AK ka përdorur procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në kushtet e nevojës ekstreme për këtë shërbim, të ardhur si pasojë e procesit gjyqësor, por nuk rezulton që AK të ketë marrë masat e nevojshme për fillimin e procedurës normale të prokurimit për sigurimin e shërbimit të ruajtjes fizike për vitin 2017. AK nuk ka argumentuar ligjërisht dhe teknikisht kërkesat e veçanta për kualifikim, në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, të ndryshuar, si dhe në disa raste, hartimi i tyre jo në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik. Hapat e ndjekur gjatë zhvillimit të këtij tenderi, tregojnë se procedura është zhvilluar formalisht nga AK. Autoriteti kontraktor ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kërkesat e kualifikimit dhe me nenet 53, pika 3, dhe 55, pika 2, të LPP.

Masat e marra	Agjencia e Prokurimit Publik bazuar në nenet 13, pika 2/g, i, 66, dhe nenit 72, pika 1/dh/gj/i të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar vendosi: • Të penalizojë me gjobë titullarin e autoritetit kontraktor; • Të penalizojë me gjobë 3 (tre) persona, në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit; • Të penalizojë me gjobë 3 (tre) persona, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
----------------------	---